

**QËNDRIMET E INSTITUCIONEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN NDAJ PAVARËSISË
SË KOSOVËS DHE PERSPEKTIVËS INTEGRUESE TË SAJ NË BE**

Tema për Titullin:

**MASTER I SHKENCËS SË STUDIMEVE EUROPIANE DHE ADMINISTRATËS
PUBLIKE**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI SHKENCA POLITIKE**

**Prishtinë
Qershor, 2026**

Qëndrimet e institucioneve të Bashkimit Evropian ndaj pavarësisë së Kosovës dhe perspektivës integruese të saj në BE

Kandidate: Edi Vokrri

Mentor: Prof. Bardhok Bashota

Bashkimi Evropian, si një aktor sui generis në sistemin ndërkombëtar, ushtron ndikim të rëndësishëm politik dhe normativ në Ballkanin Perëndimor, ku Kosova paraqet një rast specifik për shkak të statusit të saj të kontestuar ndërkombëtarisht. Pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008, marrëdhëniet mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian janë karakterizuar nga një qasje komplekse dhe jo plotësisht e unifikuar, e ndikuar nga fakti se pesë shtete anëtare të BE-së nuk e kanë njohur pavarësinë e saj. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën e formulimit të politikave evropiane ndaj Kosovës dhe në nivelin e koherencës institucionale të tyre.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë qasjen e institucioneve kryesore të Bashkimit Evropian – Komisionit Evropian, Këshillit të Bashkimit Evropian, Parlamentit Evropian dhe Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm – ndaj pavarësisë së Kosovës dhe perspektivës së saj integruese. Studimi është i bazuar në një qasje cilësore dhe analitike, duke përdorur analizën e dokumenteve zyrtare të BE-së, raporteve institucionale dhe literaturës akademike relevante.

Në funksion të realizimit të qëllimit të studimit, ky punim synon t'u përgjigjet pyetjeve kërkimore në vijim:

PK1: Si e kanë trajtuar institucionet e Bashkimit Evropian pavarësinë e Kosovës që nga shpallja e saj në vitin 2008?

PK2: A ekzistojnë dallime në qasjen e Komisionit Evropian, Këshillit të Bashkimit Evropian, Parlamentit Evropian dhe Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm ndaj pavarësisë së Kosovës?

PK3: Si ka ndikuar mosnjohja e Kosovës nga pesë shtete anëtare në formulimin dhe zbatimin e politikave të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës?

PK4: Sa koherente dhe efektive ka qenë qasja institucionale e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës në raport me procesin e integrimit evropian?

PK5: Çfarë efektesh politike dhe institucionale ka prodhuar parimi i neutralitetit ndaj statusit në dialogun Kosovë–Serbi?

Në bazë të këtyre pyetjeve kërkimore, janë ngritur hipotezat në vijim:

H1: Qasja e institucioneve të Bashkimit Evropian ndaj pavarësisë së Kosovës ka qenë e fragmentuar për shkak të mungesës së konsensusit ndërmjet shteteve anëtare.

H2: Mosnjohja e Kosovës nga disa shtete anëtare ka kufizuar koherencën dhe efektivitetin e politikave të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës.

H3: Institucionet e Bashkimit Evropian kanë treguar dallime të dukshme në qëndrimet e tyre ndaj pavarësisë së Kosovës, me Parlamentin Evropian më afirmues në mbështetjen e perspektivës evropiane të Kosovës, ndërsa Këshilli i Bashkimit Evropian më i kushtëzuar nga qëndrimet e shteteve anëtare.

Punimi është realizuar si hulumtim cilësor me qasje analitike dhe interpretive, duke u bazuar në analizën e dokumenteve zyrtare të Bashkimit Evropian, raporteve institucionale dhe literaturës shkencore relevante. Metoda kryesore e përdorur është analiza dokumentare, e cila mundëson shqyrtimin e qëndrimeve dhe politikave të institucioneve të BE-së ndaj Kosovës në periudhën pas vitit 2008.

Rezultatet e pritshme të hulumtimit tregojnë se qasja e Bashkimit Evropian ndaj pavarësisë së Kosovës është e fragmentuar dhe e ndikuar nga mungesa e konsensusit ndërmjet shteteve anëtare. Pritet të evidentohet se Komisioni Evropian ka një qasje më teknike dhe të orientuar drejt procesit të integritetit, ndërsa Këshilli i BE-së reflekton ndarjet politike të shteteve anëtare. Parlamenti Evropian pritet të shfaqë qëndrimin më mbështetës ndaj perspektivës evropiane të Kosovës. Gjithashtu, pritet të dëshmohet se parimi i neutralitetit ndaj statusit, i përdorur në dialogun Kosovë–Serbi, ka mundësuar vazhdimësinë e angazhimit të BE-së, por njëkohësisht ka kufizuar koherencën dhe efektivitetin e politikave të saj ndaj Kosovës, duke ndikuar në kompleksitetin e procesit të integritetit evropian.